



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 6 korrik 2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Doarsa Kica –Xhelili, Mërgim Lushtaku, Valon Ramadani, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi, Isak Shabani dhe Agim Veliu.

Munguan: Fidan Jilta, Besnik Tahiri dhe Igor Simiq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Doarsa Kica Xhelili-kryetare e komisionit, me këtë:

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit plotësues të Komisionit për Legjislacion, për Projektligjin nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura;**
- 4. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit plotësues të Komisionit për Legjislacion, për Projektligjin nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Doarsa Kica –Xhelili, njoftoi komisionin, se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, më datë 15.6.2022 ka shqyrtuar raportet e komisioneve të përhershme për projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ka vendosur që raporti i Komisionit funksional të adresohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Më dt. 17 qershor 2022, Komisionit iu është adresuar raporti plotësues nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë me rekomandimin si në vijim:

Projektligji nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç nenit 29, nënparagrafi 1.9. i rekomandohet Komisionit funksional që nënparagrafi 1.9 i nenit 29 të fshihet.

Konstatim: Komisioni me 5 vota për dhe 2 abstenime e miratoi amendamentin e propozuar dhe e procedoi për shqyrtim në komisionet e përhershme.

3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura

Doarsa Kica –Xhelili, njoftoi komisionin se raportet i kanë paraqitur 3 komisione të përhershme, si në vijim:

1. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, ka shqyrtuar raportin me amendamente nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar që Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
2. Komisioni për Legjislacion, ka shqyrtuar raportin me amendamente nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
3. Komisioni për Integritet Evropian, ka shqyrtuar raportin me amendamente nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ndërsa, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian nuk kanë paraqitur raportet brenda afatit të paraparë me nenin 57.8 të Rregullores.

Mërgim Lushtaku, deklaroi se anëtarët e komisionit që përfaqësojnë Grupin Parlamentar të PDK-së nuk marrin pjesë në votimin e raportit me rekomandime për projektligjin në fjalë.

Konstatim: Komisioni votoi për raportin me rekomandime, me 5 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, nuk e miratoi raportin me rekomandime për projektligjin në fjalë.

4. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr.08/L-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë

Doarsa Kica –Xhelili, njoftoi komisionin, se komisioni, më dt.15.6.2022, ia ka adresuar komisioneve të përhershme për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë.

Raportet i kanë paraqitur 3 komisione të përhershme, si në vijim:

1. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, ka shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Komisioni për Integritet Evropian, ka shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
3. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, ka shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe ka konstatuar se projektligji përmban kosto shtesë buxhetore, por të përballeshme për buxhetin e Kosovës, ndërsa amendamentet e propozuara, me përjashtim të amendamentit nr.15, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Ndërsa, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian nuk kanë paraqitur raportet brenda afatit të paraparë me nenin 57.8 të Rregullores.

Konstatim: Raporti i Komisionit funksional u miratua dhe i njëjti procedohet tutje për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

5. Të ndryshme.

Doarsa Kica- Xhelili, njoftoi komisionin se vizita në Shqipëri e organizuar për dt. 3-5 korrik 2022, është anuluar për arsye objektive dhe propozoi që vizita e radhës të realizohet në muajin shtator, atëherë kur edhe komisioni do të ketë në procedurë plotësim-ndryshimin e Ligjit për KPM-në, sipas strategjisë legjislative dhe të caktohet një vizitë në AMA.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

**Doarsa Kica- Xhelili,
Kryetare e Komisionit**
